

VENDIM
Nr. 753, datë 5.9.2013

PËR MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “ARSTI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr. 125/2013, datë 25.4.2013 “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Arsti”, që i jepet shoqërisë “Shpresa AL” sh.p.k.

2. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës në procedurën për zgjedhëse konkurruese për dhënie me koncesion të hidrocentralit “Arsti”, duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha